

VENDIM
Nr.687, datë 5.10.2011

**PËR ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË
ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA E TË KONFISKUARA, SI
DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA E TË
KONFISKUARA¹**

(Ndryshuar me VKM nr.324, datë 28.5.2014; nr.83, datë 8.2.2017)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 15 pika 2 e 34 pika 2, të ligjit nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. ORGANIZIMI I AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA E TË KONFISKUARA

1. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara është institucion qendror, me qendër në Tiranë, në varësi të Ministrit të Financave.

2. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara funksionon si autoritet përgjegjës për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara nga organet e drejtësisë apo me vendime dhe urdhra administrative sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar.

3. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Financave.

4. *Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të Agjencisë rregullohen nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil.*

Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen sipas parashikimeve të Kodit të Punës.

5. *Agjencia drejtohet nga kryeadministratori. Marrëdhëniet e punës së kryeadministratorit rregullohen nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil.*

6. Buxheti i Agjencisë përbëhet nga buxheti i shtetit, si pjesë përbërëse e buxhetit të Ministrisë së Financave, dhe nga të ardhurat e krijuara nga administrimi i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara. Buxheti i shtetit mbulon shpenzimet për mbajtjen dhe funksionimin e Agjencisë, si dhe ato për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, kur të ardhurat e siguruar nëpërmjet administrimit të këtyre pasurive nuk janë të mjaftueshme.

7. Të ardhurat nga administrimi i pasurive përdoren vetëm për të mbuluar shpenzimet e administrimit të pasurive.

8. Të ardhurat e përfuara nga tjetërsimi i pasurive të konfiskuara shkojnë në:

a) Buxhetin e Shtetit;

b) Fondin e posaçëm për parandalimin e kriminalitetit;

c) Llogarinë e Agjencisë për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.

Shpërndarja e këtij fondi përcaktohet me urdhër të Ministrit të Financave.

¹ VKM nr.687, datë 5.10.2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.146, nëntor 2011.

VKM nr. 324, datë 28.5.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 85, datë 11 qershor 2014.

VKM nr.83, datë 8.2.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.23, datë 13 shkurt 2017.

II. PËRKUFIZIME

Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoriteti përgjegjës” për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara është Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, në vijim Agjencia.
2. “Administrim i pasurisë”, të gjitha veprimet dhe procedurat ligjore që kryhen nga Agjencia apo nga administratori i pasurisë, me qëllim ruajtjen, mirëmbajtjen dhe, kur është e mundur, shtimin e vlerës së pasurisë, që nga çasti i marrjes dijeni për aktin e sekuestros/konfiskimit dhe deri në atë të tjetërsimit ose të revokimit të masës së sekuestrimit të pasurisë.
3. “Marrja në dorëzim e pasurisë”, veprimet dhe procedurat ligjore të kryera nga Agjencia dhe administratori i pasurisë, për kalimin faktik të pasurive në administrim të Agjencisë me anë të inventarizimit të dokumentuar të pasurisë.
4. “Menaxhim i drejtpërdrejtë apo me anë të të tretëve”, veprimet dhe procedurat që kryhen nga Agjencia dhe administratori i pasurisë, pas marrjes në dorëzim të pasurisë deri në çastin e tjetërsimit të saj.
5. “Tjetërsim”, kalimi i të drejtave reale të pasurisë nga pronari tek të tretët, nëpërmjet një prej formave të parashikuara nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
6. “Administrator koordinator”, punonjësi buxhetor i Agjencisë, i cili koordinon, udhëzon, mbikëqyr dhe kontrollon zbatimin e procedurave ligjore nga administratori i pasurisë, për administrimin e pasurive të sekuestruara/konfiskuara, sipas fushës përkatëse që ai mbulon (juridike, financiare, terreni etj).
7. “Administrator i pasurisë”, personi fizik a juridik, i specializuar në fushën e administrimit të pasurive, i cili është i autorizuar dhe/ose kontraktuar nga Agjencia për administrimin e pasurive të sekuestruara/konfiskuara.
8. “Njësi pasurie”, një pasuri me numër të vetëm identifikimi, i cili identifikon pasurinë (e luajtshme/paluajtshme) në regjistrat publikë të regjistrimit të pasurive.
9. “Përdorim i pasurisë”, ushtrimi i së drejtës për shfrytëzimin e pasurisë.
10. “Të ardhurat nga administrimi i pasurive”, të gjitha të hyrat në vlera monetare që përftohen nga administrimi i pasurive të sekuestruara/konfiskuara apo burime të tjera të ligjshme.
11. “Shpenzimet për administrimin e pasurive”, të gjitha të dalat në vlera monetare, që përdoren për administrimin e pasurive.

III. OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA E TË KONFISKUARA

Agjencia ka për objekt të veprimtarisë:

1. Administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara me vendim të gjykatës, në zbatim të ligjit nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.
2. Administrimin e pasurive të bllokuara dhe të sekuestruara, në zbatim të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.
3. Administrimin e pasurive të tjera të sekuestruara e të konfiskuara, të cilat janë produkt i veprave penale apo të lidhura me to, administrimi i të cilave i caktohet kësaj Agjencie me ligj, me vendim gjykate.

IV. KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E AGJENCISË

Agjencia ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

1. Merr në dorëzim pasuritë e sekuestruara e të konfiskuara, në zbatim të vendimeve të Gjykatës për Krimet e Rënda, vendimeve të Këshillit të Ministrave, urdhrave të Ministrisë të Financave, vendimeve të gjykatave të tjera apo ligjeve të veçanta.
2. Ruan, mirëmban dhe administron pasuritë e sekuestruara e të konfiskuara.
3. Rrit vlerën e pasurisë në administrim, nëse është e mundur, nëpërmjet administrimit të drejtpërdrejtë apo të të tretëve.
4. Përgatit:

a) Raporte për organin që ka vendosur masën e sekuestrimit/konfiskimit për pasurinë e marrë në administrim.

b) Raporte për Komitetin Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për masat kundër krimit të organizuar për pasuritë e konfiskuara, të paktën një herë në vit, 3-mujorin e parë.

c) Raporte tekniko-financiare për pasuritë e konfiskuara, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga marrja dëgjimi e vendimit të formës së prerë.

ç) Raportin vjetor, brenda muajit janar të vitit pasardhës, drejtuar Ministrit të Financave.

5. Paraqet kërkesat për regjistrimin në regjistrat publikë përkatës, në pronësi të shtetit, në përgjegjësi administrimi të AAPSK-së, të pasurive të konfiskuara me vendim të formës së prerë.

6. Përgatit dosjen e plotë të dokumentacionit ligjor për tjetërsimin e pasurive të konfiskuara, dhënien në përgjegjësi administrimi apo huapërdorjeje.

7. Bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për shitjen e pronave publike dhe për shitjen e pasurive të konfiskuara.

8. Mbikëqyr veprimtarinë e përfuturit, të cilit i është dhënë në përdorim një pasuri e konfiskuar, nëse përdorimi i pasurisë është në përputhje me udhëzimin e Ministrit të Financave të nxjerrë për këtë qëllim.

9. Bën verifikimin dhe përgatitjen e dokumentacionit për kërkesat për financimin e projekteve nga fondi i veçantë për parandalimin e kriminalitetit.

10. Ndërmerr nisma ligjore dhe ia propozon ato Ministrit të Financave.

V. KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E KRYEADMINISTRATORIT, ADMINISTRATORIT KOORDINATOR DHE ADMINISTRATORIT TË PASURISË

1. Kryeadministratori ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

1.1. Organizon dhe drejton veprimtarinë e Agjencisë, përgjigjet dhe raporton përpara ministrit të Financave dhe Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për masat kundër krimit të organizuar, sipas dispozitave të ligjit nr.10 192, datë 13.12.2009 "*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*", dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.

1.2. Mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë që kryhet për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.

1.3. Përfaqëson Agjencinë në marrëdhënie me të tretët, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

1.4. I paraqet Gjykatës për Krimet e Rënda, të paktën një herë në vit, brenda 3 - muajit të parë të vitit, listën e administratorëve të pasurisë, të cilët plotësojnë kriteret ligjore dhe janë të trajnuar nga Agjencia.

1.5. I paraqet Ministrit të Financave, për miratim, rregulloren e brendshme të punës së Agjencisë.

1.6. Emëron administratorët e pasurive, të caktuar nominalisht nga Gjykata për Krimet e Rënda, për pasuritë e sekuestruara/konfiskuara, sipas dispozitave të ligjit nr.10 192, datë 13.12.2009 "*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*", si dhe administratorët për pasuritë e sekuestruara/konfiskuara, që i caktohen për administrim Agjencisë sipas këtij vendimi.

1.7. Emëron ndihmësadministratorët, sipas propozimit të administratorëve të pasurisë.

1.8. Negocion dhe lidh kontratën me administratorin/ ndihmësadministratorin, sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe ligjit nr.7850, datë 29.9.1994 "Kodi Civil", të ndryshuar. Kriteret dhe limitet e pagave të administratorëve dhe ndihmësadministratorëve të pasurive përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij vendimi.

1.9. Negocion dhe lidh kontratat e qirasë, huapërdorjes dhe enfiteozës për pasuritë e sekuestruara/konfiskuara.

1.10. Lidh kontratat si përfaqësues i autoritetit kontraktor në procedurat e prokurimit publik.

1.11. Ngre komisionet për:

- Vlerësimin e çmimit të tregut për dhënien me qira të pasurive të sekuestruara/konfiskuara;
- Vlerësimin e çmimit të shitjes së pasurive të konfiskuara;
- Vlerësimin e çmimit të shitjes për pasuritë e sekuestruara për të cilat gjykata ka vendosur shitjen e tyre.

1.12. Kryeadministratori i paraqet në mënyrë progresive si Gjykatës, ashtu edhe Prokurorisë për Krimet e Rënda, të gjitha shpenzimet procedurale, që nga çasti i marrjes në dorëzim të pasurisë së administruar deri në fazën e konfiskimit të saj, sipas parashikimeve të nenit 25, të ligjit nr.10192, datë 3.12.2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*.

2. Administratori koordinator:

2.1. Administratori koordinator, sipas sektorit që mbulon, koordinon, kontrollon dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratorëve të pasurive dhe zbatimin e procedurave ligjore të administrimit të pasurive të sekuestruara/konfiskuara.

2.2. Kontrollon dhe miraton raportet e përgatitura nga administratorët e pasurive, përpara se të kalojnë për miratim te kryeadministratori.

2.3. Verifikon dhe dërgon për miratim, te kryeadministratori, kërkesat për shpenzimet për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e pasurive, të propozuara nga administratori i pasurive.

2.4. Përgatit statistika, analiza dhe raporte periodike mujore, si dhe sa herë që i kërkohen nga kryeadministratori.

2.5. Në bazë të propozimeve të administratorit të pasurive, i rekomandon kryeadministratorit mënyrën e administrimit të pasurive nëpërmjet administrimit të drejtpërdrejtë apo me anë të të tretëve.

3. Administratori i pasurisë:

3.1 Administratori i pasurisë, i emëruar nga Gjykata, për pasuritë e sekuestruara, të regjistruara në regjistra publikë, duhet të bëjë menjëherë njoftimin e masës së sekuestrimit në zyrat ku mbahen këta regjistra.

3.2 Merr në administrim pasuritë e sekuestruara/konfiskuara që i caktohen për administrim.

3.3 Administron dhe, nëse është e mundur, rrit vlerën për pasuritë që ka në administrim nëpërmjet administrimit të drejtpërdrejtë apo me anë të të tretëve.

3.4 Harton të gjitha shkresat zyrtare dhe mban korrespondencën me institucionet dhe subjektet me të cilat duhet të bashkëpunohet për marrjen në administrim, menaxhimin dhe tjetërsimin e pasurive të sekuestruara/konfiskuara.

3.5 Paraqet:

a) Raport të hollësishëm, brenda 15 ditëve nga emërimi i tij, për kryeadministratorin dhe autoritetin përkatës që ka vendosur masën e sekuestrimit/konfiskimit, për elementet thelbësore të ekzistencës dhe gjendjes së pasurisë së sekuestruar/konfiskuar, duke njoftuar njëkohësisht prokurorin e çështjes, kur pasuria është sekuestruar me kërkesë të kësaj të fundit;

b) Raport për marrjen në administrim të pasurisë, për të cilin njofton kryeadministratorin, vë në dijeni autoritetin përkatës që ka vendosur masën e sekuestrimit/konfiskimit dhe prokurorin e çështjes;

c) Raporte periodike për administrimin e pasurive të sekuestruara, sipas afateve të caktuara nga gjykata, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës;

ç) Kërkesën për informim pranë prokurorisë dhe gjykatës, 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të masës së sekuestrimit, me qëllim marrjen dijeni nga ana e prokurorit të kërkesës për konfiskim apo shtyrje të afatit të sekuestrimit;

d) Raportin tekniko-financiar, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e formës së prerë, për konfiskimin e pasurisë;

dh) Raportin për pasuritë e tjera, që mund të jenë objekt i masës së sekuestrimit, për

ekzistencën e të cilave është vënë në dijeni gjatë administrimit, por nuk janë përcaktuar në masën e sekuestrimit/konfiskimit, dhe ia paraqet atë autoritetit përkatës që ka vendosur masën e sekuestrimit/konfiskimit dhe kryeadministratorit.

3.6. Administratori nuk lejohet të marrë pjesë në gjykim, të marrë kredi, të nënshkruajë marrëveshje pajtimi, arbitrazhi, premtimi, dorëzanie, hipotekimi ose tjetërsimi të pasurive të sekuestruara/konfiskuara, apo të kryejë veprime të tjera juridike administrimi jo të zakonshëm.

VI. ADMINISTRIMI I PASURIVE TË SEKUESTRUARA E TË KONFISKUARA

Administrimi i pasurive nga Agjencia kalon në tri faza:

- Marrjen në administrim;
- Menaxhimin;
- Tjetërsimin, dhënien në përgjegjësi administrimi dhe huapërdorje.

1. Marrja në administrim

a) Marrja në administrim fillon me marrjen dijeni për aktin e nxjerrë nga autoriteti që ka vendosur masën e sekuestrimit/konfiskimit ndaj pasurisë ose me marrjen dijeni, prej prokurorisë, të kërkesës për sekuestrim/konfiskim, që kjo e fundit i drejton gjykatës.

b) Marrja në administrim bëhet nga administratori i pasurisë në prani të administratorit që merret me koordinimin në terren ose, në mungesë të këtij të fundit, të një administratori/administratori të pasurisë, të caktuar nga kryeadministratori.

c) Ekzekutimi i masës së sekuestrimit/konfiskimit për pasuritë e sekuestruara/konfiskuara, që i caktohen për administrim Agjencisë me vendim të Gjykatës për Krimet e Rënda, bëhet sipas Kodit të Procedurës Civile, nëpërmjet përmbaruesit gjyqësor.

ç) Përmbaruesi gjyqësor dokumenton inventarizimin e pasurive të sekuestruara/konfiskuara, në prani të administratorit të pasurisë dhe ia dorëzon këtij të fundit me procesverbal, të nënshkruar nga të pranishmit, duke zbatuar procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

d) Administratori i pasurisë, pas marrjes në dorëzim të pasurive, harton raportin përkatës, njofton kryeadministratorin dhe autoritetin që ka vendosur masën e sekuestrimit/konfiskimit të pasurisë.

2. Menaxhimi

a) Administratori i pasurisë kryen një studim fizibiliteti për pasurinë e marrë në administrim dhe ia paraqet atë kryeadministratorit, i cili merr vendimin përkatës për mënyrën e menaxhimit të pasurisë, nëpërmjet menaxhimit të drejtpërdrejtë nga Agjencia apo të tretëve, duke ua dhënë atyre me qira.

b) Pas marrjes në administrim të pasurisë, administratori i pasurisë merr masa për sigurimin e domosdoshëm të pasurisë, duke lidhur kontrata sigurimi për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë. Për sigurimin e këtyre shërbimeve zbatohen procedurat e prokurimit publik.

c) Pasuritë e tundshme/luajtshme transportohen dhe ruhen në mjediset e caktuara nga Agjencia, përveç rasteve kur këto pasuri janë pjesë e veprimtarisë së një biznesi apo kur ato shërbejnë për dhënien e pasurisë me qira.

ç) Pasuritë e tundshme/luajtshme në formë të mjeteve monetare, investohen në bono thesari ose depozitohen në llogari bankare të caktuara, për të cilat vendos kryeadministratori. Kriteret e përzgjedhjes së bankave ku do të depozitohen mjetet monetare përcaktohen në udhëzimin e Ministrisë të Financave.

d) Administratori i pasurisë i paraqet për miratim kryeadministratorit planveprimin për zbatimin e mënyrës së menaxhimit, të vendosur pas studimit të fizibilitetit. Në këtë plan përfshihen edhe të ardhurat dhe shpenzimet e parashikuara.

dh) Kryeadministratori, me kërkesë të administratorit të pasurisë, mund të autorizojë, sipas nevojës, ndihmën e specialistëve të fushave të ndryshme apo të personave të tjerë, të cilët shpërblehen për punën e bërë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

e) Në rastet e menaxhimit të drejtpërdrejtë zbatohen të gjitha procedurat ligjore në fuqi

për funksionimin e një veprimtarie ekonomike në Republikën e Shqipërisë.

ë) Në rastet e dhënies me qira të pasurive të sekuestruara, kryeadministratori ngre komisionin për vlerësimin e çmimit të tregut. Nëse është e pamundur dhënia me qira me çmimin e tregut, me propozimin e administratorit të pasurisë, çmimi i qirasë mund të negociohet nga kryeadministratori.

f) Në rast të revokimit të vendimit të sekuestrimit, Agjencia, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e vendimit, bën njoftimin e personit që i është sekuestruar pasuria për datën e kthimit dhe përpilon procesverbalin e dorëzimit të pasurisë, duke kryer raportin përfundimtar për mbylljen e dosjes dhe të kartelës përkatëse. Agjencia, gjithashtu, njofton të gjitha institucionet përkatëse për revokimin e pasurisë.

3. Tjetërsimi, dhënia në përgjegjësi administrimi dhe huapërdorja

a) Komiteti Këshillimor Ndërinstitucional i Ekspertëve për Masat Kundër Krimin të Organizuar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e raportit tekniko-financiar, i dërgon Ministrin të Financave rekomandimet për mënyrën dhe kushtet e përdorimit të pasurive të konfiskuara.

b) Ministri i Financave, bazuar në rekomandimet e Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimin të Organizuar dhe raportin tekniko-financiar, me urdhër, vendos për tjetërsimin, përcakton mënyrën dhe kushtet e përdorimit të pasurive të konfiskuara dhe nxjerr udhëzimet shoqëruese të përdorimit (në rastin e dhënies në përgjegjësi administrimi), brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga paraqitja e raportit të vlerësimit tekniko-financiar, por jo më vonë se 120 (njëqind e njëzet) ditë nga data e njoftimit të vendimit gjyqësor.

c) Në zbatim të vendimit të formës së prerë të gjykatës për konfiskimin e pasurive, Agjencia bën kërkesën pranë institucioneve përgjegjëse për kalimin e pasurisë në pronësi të shtetit dhe në administrim të Agjencisë.

ç) Agjencia përgatit dosjen e plotë të dokumentacionit ligjor për tjetërsimin (shitjen, dhënien në përgjegjësi administrimi apo huapërdorje) e pasurive të konfiskuara

d) Agjencia mbikëqyr veprimtarinë e përfituesit, të cilit i është dhënë në përdorim (përgjegjësi administrimi apo huapërdorje) një pasuri e konfiskuar, nëse përdorimi i pasurisë është apo jo në përputhje me udhëzimin e ministrit të Financave të nxjerrë për këtë qëllim.

dh) Gjykata, kryesisht ose me kërkesë të palëve, për pasuritë e sekuestruara, të cilat dëmtohen, u bie vlera në mënyrë të ndjeshme ose dalin jashtë përdorimit, mund të vendosë kalimin e të drejtave reale tek të tretët, nisur nga parimet e miradministrimit të pasurisë.

e) Në zbatim të vendimit të gjykatës, me kërkesë të Agjencisë, pasuritë e përshkuara në shkronjën “dh” të kësaj pike, shiten me ankand nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike. Të ardhurat nga shitja e këtyre pasurive depozitohen në llogarinë e Agjencisë. Në rast revokimi të masës së sekuestros zbatohet vendimi i gjykatës për kthimin e kundërvlerës së pasurisë së shitur.

VII. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PËR ADMINISTRIMIN E PASURIVE TË SEKUESTRUARA E TË KONFISKUARA

1. Të ardhurat nga administrimi i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara përftohen nga:

- Dhënia me qira e pasurisë/pasurive;
- Administrimi i drejtpërdrejtë apo nëpërmjet të tretëve i veprimtarive ekonomike;
- Interesat e përfituara nga depozitimi i vlerave monetare në llogari bankare apo bono thesari;

ç) Të ardhurat nga tjetërsimi i pasurive të konfiskuara;

d) Të ardhurat nga shitja e pasurive, sipas shkronjës “e”, të pikës 3, të kreut VI;

dh) Të ardhura të tjera në çdo lloj cilësie a burimi të ligjshëm.

2. Shpenzimet për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara:

2.1. Shpenzimet përbëhen nga:

- shpenzimet për pagesën e administratorit të pasurisë dhe të personelit ndihmës, nëse

ka;

- b) shpenzimet për marrjen në administrim të pasurive;
- c) shpenzimet e shërbimeve të transportit të pasurive të luajtshme të sekuestruara/konfiskuara;
- ç) shpenzimet për shërbimet e ruajtjes dhe të sigurisë fizike;
- d) shpenzimet për shërbimet e siguracioneve të domosdoshme;
- dh) shpenzimet për shërbimet e mirëmbajtjes;
- e) shpenzimet që lidhen me shërbimet (riparime, rikonstruksione, rregullime etj.) për mundësimin e veprimtarisë në ato pasuri të cilat mund të gjenerojnë të ardhura;
- ë) shpenzimet për pagesën e shërbimeve të ekspertizës dhe këshillimit teknik, për pasuritë e sekuestruara e të konfiskuara;
- f) shpenzimet për administrimin e llogarive bankare;
- g) shpenzimet për kalimin e pronësisë në regjistrat publikë të pasurive të konfiskuara;
- gj) tatimet, taksat kombëtare dhe lokale.

2.2. Shpenzimet për administrimin e pasurive kryhen nga Agjencia, me kërkesën e administratorit të pasurisë dhe miratimin e kryeadministratorit, përveç rasteve të administrimit të drejtpërdrejtë të pasurive.

2.3. *Procedurat e kryerjes së shpenzimeve realizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.*

VIII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë udhëzimin e detajuar në zbatim të këtij vendimi.

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.314, datë 5.5.2010 “Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe përcaktimin e shpërblimit të personave të tretë në administrimin e pasurisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha